

Mund të konsideroheni punonjës i padeklaruar nëse...

*Paguheni me para në dorë, pa kontratë –
punë e padeklaruar*

Nëse nuk keni kontratë të shkruar dhe punëdhënësi juaj ju paguan me para në dorë, pa e regjistruar punën tuaj apo pa paguar taksat dhe kontributet shoqërore, atëherë po punoni i padeklaruar.

*Një pjesë e pagës suaj ju paguhet me para në dorë –
punë e padeklaruar*

Nëse punëdhënësi juaj deklaron vetëm një pjesë të orëve të punës dhe pjesën tjetër e paguan me para në dorë, po punoni të padeklaruar. Këtu përfshihen orët shtesë të padeklaruar dhe turnet shtesë. Mund të duket me leverdi, por kjo gjë redukton të drejtat tuaja dhe ju lë pa vërtetimin e plotë të punës.

*Jeni i vetëpunësuar, por trajtoheni si punonjës –
vetëpunësim në varësi*

Nëse jeni regjistruar si i vetëpunësuar, por punoni nën kontrollin e një menaxheri, ndiqni orare fikse apo mbështeteni te një klient, mund të jeni në vetëpunësim të rremë. Kjo do të thotë se trajtoheni si një punonjës pa të drejta ose mbrojtje. Në disa shtete, edhe pse je i regjistruar si i vetëpunësuar, mund të konsiderohesh si punonjës me të drejta të plota punësimi, sidomos kur dikush ju drejton punën, cakton pagën tuaj dhe e kryeni punën vetë.

Çfarë mund të bëni?

1. Kontaktoni me inspektoratin tuaj vendas të punës

Inspektoratet e punës dhe organizatat kontrollojnë dhe inspektojnë bizneset. Ato mund të japin këshilla se si të raportohet puna e padeklaruar. Inspektoratet e punës shpesh japin informacione rreth të drejtës suaj për të pretenduar çdo pagë të papaguar, në përputhje me të legjislationin e BE-së.

2. Kontaktoni një sindikatë

Sindikatat përfaqësojnë punonjësit, promovojnë të drejtat dhe kushtet më të mira të punës. Ato angazhohen në dialog me organizatat e punëdhënësve. Kontaktoni me sindikatën tuaj ose me përfaqësuesit e vendit tuaj të punës.



Për më tepër

Në faqen e internetit të **Autoritetit Evropian të Punës**, mund të gjeni pikën e kontaktit për vendin tuaj dhe të merrni këshilla.

<https://www.ela.europa.eu>



Autoriteti Evropian i Punës
Landererova 12, 811 09 Bratislava I, Slovakia



Publications Office
of the European Union

Luksemburg: Zyra e Botimeve të Bashkimit Evropian, 2025

© Autoriteti Evropian i Punës, 2025

Print ISBN 978-92-9415-231-2 doi:10.2883/4344995 HP-01-25-025-SQ-C

PDF ISBN 978-92-9415-230-5 doi:10.2883/0514993 HP-01-25-025-SQ-N

Ballina, © Gorodenkoff/stock.adobe.com; © JackF/stock.adobe.com; © wave-break3/stock.adobe.com. Fletët e brendshme, © K Seisa/peopleimages.com/stock.adobe.com; © New Africa/stock.adobe.com



Përfitime të deklaruara nga punësimi për të gjithë!



SQ



Jeni punonjës?

Çfarë është puna e deklaruar?

- Mbrojtje dhe përfitime: pension, sigurime shoqërore, kujdes shëndetësor, leje e paguar pushimesh dhe mbrojtje nga pushimi i padrejtë nga puna apo nga shkeljet e tjera të ligjit për punësimin.
- Pagesë e rregullt e pagave, e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe e taksave përkatëse.

A po punoj si i deklaruar?

Lista e kontrollit

Duhet të keni...

- **Kontratë punësimi** që tregon kushtet e punës, detyrimet dhe të drejtat, informacionin rreth punëdhënësit dhe kush është përgjegjës për pagën tuaj.
- **Pagesa të rregullta** të rakorduara sipas orëve reale të punës, orëve jashtë orarit, shtesave të posaçme (p.sh. për turnet e natës ose në raste festash zyrtare).
- **Mbrojtje nga diskriminimi** në vendin e punës me bazë seksin, gjininë, besimin fetar, kombësinë apo etninë.
- **Të drejtën për pushime të shkurtra**, pushime vjetore dhe ditë lejeje.
- **Të drejtën për leje në rast sëmundjeje** dhe për të qenë i mbrojtur në rast aksidentesh në punë dhe sëmundjesh profesionale.
- **Regjistrim në sistemin e sigurimeve shoqërore** për, p.sh. pensione, papunësi, kujdes shëndetësor.
- **Të drejtën e përfaqësimit**, e anëtarësisë në sindikata dhe të grevës.
- **Pagesë të rregullt të kontributeve**, p.sh. kontributet e pensioneve.

Drejtoni një biznes?

A punësoni apo planifikoni të punësoni punonjës?

Çfarë është puna e deklaruar?

- Respektimi i rregullave dhe rregulloreve të punësimin; punonjësve t'u jepen të drejtat që u takojnë.
- Garantimi i konkurrencës së drejtë ndërmjet bizneseve.
- Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm dhe të motivuar pune, që çon në një vend produktiv pune.
- Shmangia e sanksioneve, gjobave, padive dhe rreziqeve reputacionale.

Si pronar biznesi dhe punëdhënës, ju duhet...

- T'i kushtoni vëmendje kushteve të punësimin të përcaktuara në rregulloret e shtetit tuaj. Kontrolloni nëse:
 - ▶ jeni në përputhje me rregullat e brendshme të kontratave kolektive për pagat dhe kostot e reduktuara;
 - ▶ po i paguani taksat dhe kontributet e detyrimeve shoqërore sipas rregullave;
 - ▶ fletëpagesat po i lëshoni të sakta;
 - ▶ lejet në rast sëmundjeje apo barrëindjeje dhe lejet për pushimet vjetore/verore/ të paguara po i jepni në përputhje me rregulloret përkatëse.
- T'i regjistroni punonjësit e deklaruar, orët e tyre reale të punës dhe të gjithë informacionin për pagesat, sipas rregullave të zbatueshme kombëtare dhe të BE-së.
- Të zbatoni rregullat për shëndetin dhe sigurinë në punë, duke ofruar kështu një mjedis të sigurt për punonjësit tuaj.
- Të siguroheni që punonjësit tuaj kanë të drejtë të punojnë ligjërisht në shtetin tuaj.

Nëse keni një biznes dhe nuk jeni të sigurt për rregullat e shtetit tuaj për punësimin ligjor të punonjësve, mund...

- Të kontaktoni me inspektoratin tuaj vendas të punës.
- Të kontaktoni organizatat tuaja kombëtare dhe/ose lokale të punëdhënësve.
- Të kontaktoni institucionet kompetente për rregullat e punësimin dhe shëndetin e sigurinë në punë.

